



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1669/1 prot.

Datë 09/09/2021

**V E N D I M**  
**Nr. 588/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09/09/2021 shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:** Rivleresimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MIFEEL” SHPK në procedurën e prokurimit “*Prokurim me vlerë të vogël*”, me Nr. REF-03639-08-24-2021, me objekt: “Shërbim 3D (dezinfektim, dezinfektim, deratizim) përfshirë dhe Covid-19 në institucionet arsimore, etj.”, me vlerë oferte 288.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.08.2021 nga autoriteti kontraktor Bashkia Tepelenë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “MIFEEL” SHPK  
Adresa: Lagjja “18 Shtatori”, rruga “Studenti”, objekti nr. 27/6, Gjirokastër.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tepelenë  
Adresa: Sheshi “Lord Bajron”, Tepelenë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Rregullat e Prokurimit Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit*

*të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### **Vëren:**

#### **I**

##### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

#### **II**

##### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24.08.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Prokurim me vlerë të vogël*”, me Nr. *REF-03639-08-24-2021*, me objekt: “Shërbim 3D (dezinfektim, dezinfektim, deratizim) përfshirë dhe Covid-19 në institucionet arsimore etj.” zhvilluar në datën 26.08.2021 nga autoriteti kontraktor Bashkia Tepelenë.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 26.08.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Alfred Bënja” P.F	0 lekë	Skualifikuar
2. “MELDI” SHPK	150.100 lekë	Kualifikuar
3. “Dorian Trimi” P.F	151.400 lekë	Kualifikuar
4. “Alpest” SHPK	222.400 lekë	Kualifikuar

5. “MEDIAL” SHPK	250.000 lekë	Kualifikuar
6. “Sofia Myftari” PF	260.000 lekë	Kualifikuar
7. “MURATI BA” SHPK	268.000 lekë	Kualifikuar
8. “Lisand Xhelili” P.F	279.000 lekë	Kualifikuar
9. “SADIK XHELILI” P.F	288.000 lekë	Kualifikuar
10. “MIFEEL” SHPK	288.000 lekë	Kualifikuar
11. “GRIFIN ALBANIA” SHPK	288.900 lekë	Kualifikuar
12. “AIR” SHPK	295.000 lekë	Kualifikuar
13. “EGIAN MED” SHPK	299.000 lekë	Kualifikuar
14. “M E T A N I” SHPK	380.000 lekë	Skualifikuar
15. “FLORFARMA” SHPK	400.000 lekë	Skualifikuar
16. “J & M TRADE” SHPK	500.000 lekë	Skualifikuar
17. “XH-N-SH GROUP” SHPK	515.500 lekë	Skualifikuar
18. “MARJO – MONDI” SHPK	524.000 lekë	Skualifikuar
19. “MEDICA-VET” SHPK	600.000 lekë	Skualifikuar
20. “Pastrime Silvio	689.000 lekë	Skualifikuar
21. “Besnik Çera” P.F	690.000 lekë	Skualifikuar
22. “ALPEN PULITO” SHPK	777.000 lekë	Skualifikuar
23. “Fran Dedndreaj” P.F	795.000 lekë	Skualifikuar
24. “ECO-PROJECT ALBANIA” SHPK	800.000 lekë	Skualifikuar

II.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), konstatohet se në datë 02.09.2021 është publikuar “Njoftimi i fituesit” për operatorin ekonomik “Lisand Xhelili” P.F, i cili është renditur me ofertë ekonomike më të vogël se shoqëria ankimuese “MIFEEL” SHPK.

II.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), konstatohet se në datë 07.09.2021 operatori ekonomik “Lisand Xhelili” P.F ka lidhur kontratën me autoritetin kontraktor Bashkia Tepelenë për procedurën e prokurimit objekt ankimimi.

II.5. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues “MIFEEL” SHPK të paraqitur pranë KPP, konstatohet se operatori ekonomik ankimues në datën 05.09.2021, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor në rrugë elektronike me anë të të cilit kërkon rivlerësimin e ofertës së paraqitur prej tij, si dhe shpjegime nga ana e autoritetit kontraktor se ku është mbështetur në hartimin e kriterëve kualifikuese të dhëna në “Ftesën për ofertë” të publikuar nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 07.09.2021, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, si dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### Arsyeton:

III.1. Në datën 24.08.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Prokurim me vlerë të vogël*”, me Nr. REF-03639-08-24-2021, me objekt: “Shërbim 3D (dezinfektim, dezinfektim, deratizim) përfshirë dhe Covid-19 në institucionet arsimore etj.” zhvilluar në datën 26.08.2021 nga autoriteti kontraktor Bashkia Tepelenë.

III.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 26.08.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Alfred Bënja” P.F	0 lekë	Skualifikuar
2. “MELDI” SHPK	150.100 lekë	Kualifikuar
3. “Dorian Trimi” P.F	151.400 lekë	Kualifikuar
4. “Alpest” SHPK	222.400 lekë	Kualifikuar
5. “MEDIAL” SHPK	250.000 lekë	Kualifikuar
6. “Sofia Myftari” PF	260.000 lekë	Kualifikuar
7. “MURATI BA” SHPK	268.000 lekë	Kualifikuar
8. “Lisand Xhelili” P.F	279.000 lekë	Kualifikuar
9. “SADIK XHELILI” P.F	288.000 lekë	Kualifikuar
10. “MIFEEL” SHPK	288.000 lekë	Kualifikuar
11. “GRIFIN ALBANIA” SHPK	288.900 lekë	Kualifikuar
12. “AIR” SHPK	295.000 lekë	Kualifikuar
13. “EGIAN MED” SHPK	299.000 lekë	Kualifikuar
14. “M E T A N I” SHPK	380.000 lekë	Skualifikuar
15. “FLORFARMA” SHPK	400.000 lekë	Skualifikuar
16. “J & M TRADE” SHPK	500.000 lekë	Skualifikuar
17. “XH-N-SH GROUP” SHPK	515.500 lekë	Skualifikuar

18. “MARJO – MONDI” SHPK	524.000 lekë	Skualifikuar
19. “MEDICA-VET” SHPK	600.000 lekë	Skualifikuar
20. “Pastrime Silvio	689.000 lekë	Skualifikuar
21. “Besnik Çera” P.F	690.000 lekë	Skualifikuar
22. “ALPEN PULITO” SHPK	777.000 lekë	Skualifikuar
23. “Fran Dedndreaj” P.F	795.000 lekë	Skualifikuar
24. “ECO-PROJECT ALBANIA” SHPK	800.000 lekë	Skualifikuar

III.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), konstatohet se në datë 02.09.2021 është publikuar “Njoftimi i fituesit” për operatorin ekonomik “Lisand Xhelili” P.F, i cili është renditur me ofertë ekonomike më të vogël se shoqëria ankimuese “MIFEEL” SHPK.

III.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), konstatohet se në datë 07.09.2021 operatori ekonomik “Lisand Xhelili” P.F ka lidhur kontratën me autoritetin kontraktor Bashkia Tepelenë për procedurën e prokurimit objekt ankimimi.

III.5. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues “MIFEEL” SHPK të paraqitur pranë KPP, konstatohet se operatori ekonomik ankimues në datën 05.09.2021, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor në rrugë elektronike me anë të të cilit kërkon rivlerësimin e ofertës së paraqitur prej tij, si dhe shpjegime nga ana e autoritetit kontraktor se ku është mbështetur në hartimin e kriterëve kualifikuese të dhëna në “Ftesën për ofertë” të publikuar nga autoriteti kontraktor.

III.6. Në datën 07.09.2021, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.7. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 116 “Ankesat për prokurimet me vlerë të vogël”, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: “1. Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, operatorët ekonomikë kanë të drejtën të ankohen vetëm në autoritetin ose entin kontraktor brenda 2 ditëve nga shpallja e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik.

2. Me marrjen dijani të ankesës së paraqitur, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vijimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës. Brenda 2 ditëve nga marrja e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet me vendim për pranimin ose refuzimin e saj.

3. Ndaj vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen në gjykatën përkatëse që shqyrton mosmarrëveshjet administrative. Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurën, lidhjen e kontratës ose ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.

4. Rregulla të hollësishme për shqyrtimin e ankesës për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël parashikohen në rregullat e prokurimit publik.

III.8. Në nenin 56 pika 1 dhe 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” parashikohet: “1. Autoriteti/enti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime, kur vlera e përlllogaritur është ndërmjet kufijve nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë në vit, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 41, të LPP-së.

[...]

8. Në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël zbatohen parashikimet e nenit 116 të LPP-së, për ankimin administrativ.

Ndërsa në nenin 104 “Ankesat për prokurimet me vlerë të vogël” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” parashikohet:

1. Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, operatorët ekonomikë të refuzuar ose të renditur deri në vend të dhjetë, sipas përcaktimeve në nenin 56, të këtyre rregullave, kanë të drejtën të ankohen vetëm në autoritetin/entin kontraktor.

Ankesat mund të bëhen për kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë ose për procesin e vlerësimit të ofertave.

2. Operatori/ operatorët ekonomikë, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij neni, të cilët kanë pretendime për procedurën e prokurimit, mund të paraqesin ankesë me shkrim brenda 2 (dy) ditëve nga konfirmimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik.

3. Titullari i autoritetit/entit kontraktor cakton me detyrën e shqyrtimit të ankesave një person që nuk ka qenë më parë i përfshirë në procedurën respektive.

4. Me marrjen e ankesës, autoriteti/enti kontraktor pezullon vijimin e procedurës së prokurimit, deri në shqyrtimin e plotë të ankesës.

5. Personi i ngarkuar me shqyrtimin e ankesës duhet të shprehet me vendim për pranimin ose refuzimin e ankesës, brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e ankesës.

6. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këto rregulla, autoriteti/enti kontraktor, mund të vendosë:

a) pranimin e plotë të ankesës;

b) pranimin e pjesshëm të ankesës;

c) refuzimin e ankesës.

Vendimi i dhënë nga autoriteti/enti kontraktor i komunikohet menjëherë edhe në rrugë elektronike ankuesit/ankuesve.

Kundër vendimit të autoritetit/entit kontraktor, operatori ekonomik ka të drejtë të ankohet në gjykatën përkatëse që shqyrton mosmarrëveshjet administrative.

7. Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurën, lidhjen e kontratës apo ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.

III.9. Neni 23 “Verifikimi i kompetencës” i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës Së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*“Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.*

*2. Çdo ndryshim ligjor ose nënligjor i mëvonshëm i kompetencës nuk ka efekt, përveç rasteve kur organi, në të cilin procedura ka nisur, nuk ekziston më, ose kur legjislacioni i ri parashikon ndryshe.”*

Neni 24 *“Mungesa e kompetencës”* i ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës Së Shqipërisë”* i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*“1. Kur një organ publik merr një kërkesë, për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës të vet, ia përcjell kërkesën menjëherë, dhe në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj, organit publik kompetent dhe njofton kërkuuesin për këtë.*

*2. Afatet për kërkuuesin vlerësohen të respektuara nëse kërkesa është paraqitur në kohë pranë organit jokompetent, ndërsa afatet përkatëse për organin publik kompetent fillojnë të llogariten nga data e marrjes së kërkesës.*

*3. Palët nuk mund të përcaktojnë apo të ndryshojnë, me marrëveshje, kompetencën e organit publik.*

III.10. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik referuar kuadrit ligjor në fuqi, vlerëson se çështja objekt-shqyrtimi është jashtë kompetencës së tij lëndore pasi ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, nuk është objekt i ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*.

KPP gjykon, se në nenin 116 të ligjit Nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, përcaktohet qartë se për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, operatorët ekonomikë kanë të drejtën të ankohen vetëm në autoritetin ose entin kontraktor brenda 2 ditëve nga shpallja e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik dhe për vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen në gjykatën përkatëse, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative.

Gjithashtu, në nenin 56 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, përcaktohet se në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël zbatohen parashikimet e nenit 116 të LPP-së, për ankimin administrativ.

Sa më sipër, referuar dispozitave ligjore për prokurimin publik, për sa kohë për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nuk parashikohet ankimi në Komisionin e Prokurimit Publik (neni 116 të LPP-së dhe neni 104 i VKM), rrjedhimisht, për këtë lloj procedure nuk do të zbatohen dispozitat për sa i përket procedurës së ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

KPP gjykon, se në asnjë dispozitë ligjore të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, nuk përcaktohet e drejta e Komisionit të Prokurimit Publik për të shqyrtuar ankesat, sa i takon procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të zhvilluara nga autoriteti kontraktor.

KPP sqaron se *kompetenca lëndore* është e drejtë dhe detyrë e një organi që të vendosë për çështje të veçanta nga tërësia e çështjeve administrative. Çdo organ ka kompetencën e vet lëndore për të vendosur në çështje të caktuara administrative, prandaj ai duhet të ketë kujdes që

të vendosë vetëm mbi ato çështje për të cilat ka kompetencë lëndore. Caktimi i kompetencës lëndore bëhet me dispozitat që rregullojnë një fushë të caktuar ose që caktojnë kompetencat e organeve të veçanta administrative.

Sa më sipër në bazë të shqyrtimit paraprak, rezulton se Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka kompetencë lëndore në shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga ankimuesi “MIFEEL” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik” Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “MIFEEL” SHPK, në lidhje me procedurën e prokurimit “Prokurim me vlerë të vogël”, me Nr. REF-03639-08-24-2021, me objekt: “Shërbim 3D (dezinfektim, dezinfektim, deratizim) përfshirë dhe Covid-19 në institucionet arsimore etj.” zhvilluar në datën 26.08.2021 nga autoriteti kontraktor Bashkia Tepelenë.
  2. Të njoftohet Bashkia Tepelenë së bashku me aktet e dosjes objekt ankimi.
  3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**